

**VENDIM**  
**Nr.155, datë 18.3.2004**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.594, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS**  
**"ROT", NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIJË DHE ENERGETIKËS E MINISTRISË**  
**SË EKONOMISË DHE SHOQËRISË "KURUM INTERNACIONAL" SHPK, TIRANË,**  
**PËR FABRIKËN E OKSIGJENIT NË ELBASAN"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Aneksi I i Marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT", ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës e Ministrisë së Ekonomisë dhe shoqërisë "Kurum Internacional" sh.p.k., Tiranë, për fabrikën e oksigjenit në Elbasan, miratuar me vendimin nr.594, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, ndryshon dhe zëvendësohet me aneksin I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**ANEKSI I**

Planimetria e fabrikës së oksigjenit Elbasan

Sipërfaqet kryesore:

Sipërfaqja e përgjithshme 30 162,50 m<sup>2</sup>

Sipërfaqe të lira 16 658,46 m<sup>2</sup>

Rrugë e sheshe të asfaltuara 4 303 m<sup>2</sup>

Sipërfaqja e përgjithshme e objekteve 9 201,04 m<sup>2</sup>

Dimensionet e kufirit teknologjik të fabrikës të jepen në genplan

Kufizimet:

Nga veriu Rrugë dhe tokë e papunuar

Nga jugu Tokë e papunuar

Nga lindja Përroi i Kushes

Nga perëndimi Objekte të TEC-it

Fabrika e oksigjenit sh.a. (objektet)

1. Freskorja

2. Stacioni i pompave

3. Depo e perlitit

4. Magazina rikupero

5. Mensa

6. Depo e vajit

7. Godina e administratës

8. Ambiente të shërbimit mekanik

9. Reparti i bombolave

10. Dushe dhe garderoba
11. Tri sfera të depozitimit të oksigjenit
12. Stacioni i reduktimit
13. Dy kullat me kapacitet 3200 NmK
14. Salla e kompresorëve
15. Nënstacioni
16. Ambiente pune
17. Linja e tubacioneve teknologjike
18. Linjat e tensionit që lidhen me sistemin e energjisë kombëtare
19. Shtesa e mbushjes së bombolave
20. Dhoma e dezhurnit dhe e zhveshjes

*Shënim.* Bashkëngjitur paraqesim genplanin e fabrikës për koncesion.

- Kullat 6800 NmK i jepen në ruajtje firmës "Kurum International", për një periudhë 3-vjeçare. Në fund të kësaj periudhe firma "Kurum International" duhet të paraqesë planbiznesin për ristrukturimin e tyre, në të kundërt do t'i kthehen OSHA-së.

**VENDIM**  
**Nr.157, datë 18.3.2004**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.424, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE  
QË KRIJOJNË INSTITUCIONET BUXHETORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave të bëhet kjo shtesë:

-Në shkronjën "a" të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shitja e biletave të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe Teatrit Kombëtar për Fëmijë, institucione këto kombëtare, buxhetore të kulturës dhe të artit, në varësi të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, t'u mbeten këtyre institucioneve, në masën 90 për qind, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit."

2. Ngarkohen Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**